



Mapefloor System 91

SISTEM EPOKSID NE FORME LLACI PA SOLUCONE TRETESE PER DYSHEME INDUSTRIALE ME TRASHESI 6-15 mm DHE PER REKUPERIMIN E DYSHEMEVE TE VJETRA

Produktet e perdorura: PRIMER SN, MAPEFLOOR I 900, MAPEFLOOR I 300 SL, MAPEFLEX PU 21, QUARZO 0.5, QUARZO 0.25



PERSHKRIMI

MAPEFLOOR SYSTEM 91 eshte sistem epoksid ne forme llaci per trajtimin e dysHEMEVE industriale, te cilat perftojne rezistence te larte mekanike dhe kimike, papershkueshmeri ndaj vajrave dhe elementeve agresive, rezistence te larte ndaj lavazheve te vazhdueshme dhe levizjeve te karrocave dhe mjeteve te tjera levizese. Dyshemet e trajtuara gjithashtu behen te lemuara dhe te parreshqitshme dhe me pamje te bukur estetike.

FUSHAT E PERDORIMIT

MAPEFLOOR SYSTEM 91 aplikohet ne dysHEME industriale me trafik normal dhe te renduar, si: magazina, supermarkete, zona depozitimi dhe prodhimi edhe kur ka levizje te mjeteve me rrota. Sistemi ben te mundur ne kohe te shpejte edhe rekuperimin dhe riparimin e pendencave dhe defekteve te ndryshme te dysHEMEVE te betonit.

MAPEFLOOR SYSTEM perdoret, ne:

- Industrine kimike dhe farmaceutike, ne zonat e magazinimit dhe perpunimit
- Industrine ushqimore, ne zonat e prodhimit dhe te depozitimit te mallrave, edhe mbi siperfaqe ku ka trafik normal dhe te renduar
- Magazina te mekanizuara, ne te gjitha zonat
- Lokale te ftohta, ne zonat e magazinimit
- Ambiente ku nevojitet te riparohen dyshemete e demtuara

AVANTAZHET

- Siperfaqet e trajtuara behen te lemuara dhe te parreshqitshme
- I sigurte per ambientin, sepse nuk permбан solucione tretese
- I qendrueshem ndaj kohes, sepse karakterizohet nga rezistence e larte ndaj vjetersimit dhe abrazionit te shkaktuar nga shkeljet dhe lavazhet
- Rezistent ndaj pjeses me te madhe te elementeve kimike, si: acidet baze dhe acidet e holluar, vajrat dhe karburantet
- Ka karakteristika estetike dhe eshte i keshillueshem per ambiente te ekspozuara
- Lahet lehtesisht dhe nuk ndotet, prandaj eshte mjaft i keshillueshem per industrine ushqimore ne zonat e kembesoreve me trafik normal dhe te lrenduar
- Siperfaqet e trajtuara jane te vazhdueshme, me planaritete te rregullt, me pamje te bukur estetike dhe karakteristika funksionale
- Siguron raport te perkryer cmim-cilesi



Mapecolor System 91

REZISTENCA KIMIKE

Dyshemete e trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 91** rezistojne ndaj:

- Acideve minerale te holluar, si: acid kloridrik, nitrik, fosforik dhe sulfurik. Gjithashtu kane nje rezistence te limituar ndaj acideve organike
- Alkaleve, hidroksidit te natriumit me perqendrim 50% dhe detergjenteve te perdorur per pastrimin e dysHEMEVE me perqendrim 20-30%
- Sheqerit, edhe ne kontakt te vazhdueshem
- Vajrave minerale dhe karburanteve

NGJYRAT

MAPEFLOOR SYSTEM 91 eshte i disponueshem ne 19 ngjyra. Ngjyrat jepen ne skeden teknike te **MAPECOLOR PASTE** per **MAPEFLOOR I 300 SL**.

KONSUMI

Te dhenat e konsumit i referohen aplikimit te sistemit ne temperatura nga +15°C deri ne +25°C dhe ne siperfaqe te sheshta dhe kompakte te betonit te lemuara me gure diamanti ose te cukitura lehte. Siperfaqet e ashpra dhe temperaturat me te uleta rrisin konsumin dhe zgjasin kohen e tharjes. Konsumi i **PRIMER SN** ndryshon ne varesi te tipit dhe te thellesise se pergatitjes se suportit.

MAPEFLOOR SYSTEM 91 per trashesi 7 mm

Primer ngjites:	PRIMER SN (A+B)	0.7 kg/m ²
Shperndarja e llacit:	MAPEFLOOR I 900 (A+B)	0.9 kg/m ²
	QUARZO 1.9	11.0 kg/m ²
Dora e pare:	MAPEFLOOR I 300 SL (A+B+MAPECOLOR PASTE)	0.9 kg/m ²
	QUARZO 0.25	0.2 kg/m ²
Dora e dyte:	MAPEFLOOR I 300 SL (A+B+MAPECOLOR PASTE)	0.5 kg/m ²
	QUARZO 0.25	0.3 kg/m ²
Finitura:	MAPEFLOOR I 300 SL (A+B+MAPECOLOR PASTE)	0.5 kg/m ²
	QUARZO 0.5	0.5 kg/m ²

Ne rastet kur **MAPEFLOOR I 300 SL** eshte i ngjyrosur, nuk shtohet komponenti **MAPECOLOR PASTE**.

PERGATITJA E SIPERFAQES

1. Karakteristikat e suportit

Para aplikimit te sistemit **MAPEFLOOR SYSTEM 91** eshte e nevojshme te behet analiza e suportit qe do te trajtohet. Per nje realizim te perkryer te trajtimit, duhet qe:

- Suporti te mos kete rrudha me te medha se 2 mm
- Rezistenca ne zgjatim e suportit duhet te jete me e madhe se 1.5 N/mm²
- Suporti te mos kete materiale qe pengojne ngjitjen e produkteve, si:
 - mbetje cemento
 - pluhur dhe pjese te shkeputura
 - produkte te stazhionuara, dyll, parafine, etj
 - njolla vaji ose shtresa rezine
 - mbetje boje ose produkte kimike
- Cdo lloj elementi ndotes qe mund te pengoje ngjitjen duhet hequr para fillimit te punimeve. Ne rastet kur suporti eshte i ndotur nga keto elemente, duhet te merren masat qe te pastrohen siperfaqet me metoda specifike.
- Suporti te trajtohet me shtrese me avull, Ne rastet kur suporti nuk eshte trajtuar ne menyre te tille, perdoret **MAPEFLOOR SYSTEM 52**, sepse perdorimi i **MAPEFLOOR SYSTEM 91** mund te krijojte shkeputje ose pjese te ngritura ose te fryra.

Mapecolor System 91

Ne rast se permbushen kerkesat e mesiperme, mund te aplikohet **MAPEFLOOR SYSTEM 91** ne dysHEME industriale betoni, mbi masete me baze cemento ose te modifikuar me polimere, mbi masete me tkurrje te kontrolluar te pergatitur me **MAPECEM** ose **TOPCEM**, mbi pllaka mermeri dhe mbi dysHEME qeramike.

2. Pergatitja e suportit

Nje siperfaqe e pergatitur mire, eshte elementi kryesor per te siguruar nje aplikim perfekt dhe per te garantuar karakteristikat e **MAPEFLOOR SYSTEM 91**. Menyra e keshilluar per pergatitjen e suportit eshte frezimi, ose ne alternative cukitja dhe heqja e pluhurave. Per pastrimin e siperfaqeve nuk jane te keshillueshme menytrat kimike, si lavazhet me acide. Demtimet e suportit, si gropat e vogla dhe plasaritjet, riparohen duke perdorur **EPORIP**, **PRIMER SN** ose **MAPEFLOOR I 900** dhe duke i shtuar **QUARZO 0.5** ne varesi te permasave dhe thellesise se demtimeve. Ne rastet kur eshte e nevojshme perforcimi i suportit, perdoret **PRIMER MF** ose **PRIMER EP** na varesi te porozitetit te suportit. Ne rastet kur paraqiten demtime me te medha ose zona te degraduara te suportit, perdoret **MAPEFLOOR I 900** dhe **QUARZO 1.9**, ose produkte te linjes **MAPEGROUT**.

3. Verifikimi paraprak i aplikimit

Pasi sigurohet qe suportit te jete pergatitur dhe te permbushet karakteristikat e lartpermendura, verifikohet qe temperatura e ambientit te jete me madhe se +8 °C (temperatura ideale eshte +15-+25°C) dhe temperatura e suportit mbi piken e kondensimit te jete te pakten +3 °C.

4. Pergatitja dhe aplikimi i produkteve

Pergatitja dhe aplikimi i produkteve behet sipas pershkrimeve ne skedat teknike te produkteve qe perbejne sistemin **MAPEFLOOR SYSTEM 91**.

• Primer ngjites (PRIMER SN)

Hidhet komponenti B (4kg) ne komponentin A (16 kg) dhe perzihen me trapano derisa te perftohet nje perzierje homogjene. Produkti aplikohet mbi dysHREME me nje rul dhe llaci duhet te hidhet derisa shtresa e primerit te jete akoma e fresket.

• Shperndarja e llacit

Hidhet ne betoniere nje sasi prej 180 kg **QUARZO 1.9** dhe fillohet te pergatitet **MAPEFLOOR I 900**. Hidhet komponenti B (5kg) ne komponentin A (10kg) dhe perzihen me trapano derisa te perftohet nje perzierje homogjene. Produkti hidhet ne betonieren me **QUARZO 1.9** dhe vazhdohet te perzihet derisa te perftohet nje perzierje e re homogjene ne formen e dheut te lagur. Perzierja hidhet mbi shtresen me primer ngjites akoma te fresket.

• Kompaktesimi dhe lemimi i llacit

Lemimi i siperfaqes duhet bere me mjete specifike vibruese dhe kompaktesuese (helikopter) derisa llaci te jete akoma i fresket.

• Dora e pare (MAPEFLOOR I 300SL)

Hidhet komponenti B (2kg) ne komponentin A (6kg), shtohet ngjyruesi **MAPECOLOR PASTE** (per cdo njesi **MAPEFLOOR I 300 SL** shtohet 0.7 kg **MAPECOLOR PASTE**) dhe perzihen me trapano me numer te vogel xhirosh derisa te perftohet nje perzierje homogjene. Perzierjes i shtohet 1.8 kg **QUARZO 0.25** dhe perzihet perseri per disa minuta derisa te perftohet nje perzierje e re homogjene. Sasia e **QUARZO 0.25** mund te ndryshoje ne varesi te porozitetit te llacit. Perzierja hidhet mbi shtresen e meparshme dhe shperndahet me shpatull amerikane.

• Prerja dhe ngjitja e xhuntove te dilatacionit (MAPEFLOOR PU 21)

Prerja e xhuntove behet sipas pozicionit te xhuntove te meparshme dhe me pas behet ngjitja e tyre me **MAPEFLEX PU 21**.

• Dora e dyte (MAPEFLOOR I 300SL)

Shtresa e dyte me **MAPEFLOOR I 300 SL** behet pas tharjes se plote te shtreses se pare ose brenda 12 oresh. Hidhet komponenti B (2kg) ne komponentin A (6kg), shtohet ngjyruesi **MAPECOLOR PASTE** (per cdo njesi **MAPEFLOOR I 300 SL** shtohet 0.7 kg **MAPECOLOR PASTE**) dhe perzihen me trapano me numer te vogel xhirosh derisa te perftohet nje perzierje homogjene. Perzierjes i shtohet 4.8 kg **QUARZO 0.25** dhe perzihet perseri per disa minuta derisa te perftohet nje perzierje e re homogjene. Perzierja hidhet mbi shtresen e meparshme dhe shperndahet me shpatull amerikane.

Mapefloor System 91

• Finitura (MAPEFLOOR I 300 SL)

Hidhet komponenti B (2kg) ne komponentin A (6kg), shtohet ngjyruesi **MAPECOLOR PASTE** (per cdo njesi **MAPEFLOOR I 300 SL** shtohet 0.7 kg **MAPECOLOR PASTE**) dhe perzihen me trapano me numer te vogel xhirosh derisa te perftohet nje perzierje homogjene. Perzierjes i shtohet 0.8 kg **QUARZO 0.5** dhe perzihet perseri per disa minuta derisa te perftohet nje perzierje e re homogjene. Produkti aplikohet ne menyre uniforme dhe te vazhdueshme me ane te nje ruli ne menyre qe siperfaqja e trajtuar te mos ketë defekte.

5. Tharja dhe kalueshmeria

Siperfaqet e trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 91**, ne nje temperature +25 °C, mund te shkelen me kembe dhe kalohen pas vetem 16 oresh. Per kalimin e karrocave te lehta dhe mjeteve te tjera levizese duhet te pritet nje dite nga aplikimi i dores se fundit. Ne temperatura me te uleta, kohet e tharjes dhe te kalueshmerise rriten me teper.

PASTRIMI DHE MIREMBAJTJA

Pastrimi dhe mirembajtja e rregullt shton jetegjatesine e siperfaqeve te trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 91**, permireson aspektin estetik dhe redukton akumulimin e papastertive. Zakonisht siperfaqet e trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 33** lahen lehtesisht me detergjente alkaline te holluar me uje. Gjithashtu ka edhe detergjente te pershtatshem per pastrimin e dysHEMEVE me rezine.

SHENIME

Te dhenat e sigurise jepen ne skedat e sigurise te cdo produkti qe perben sistemin **MAPEFLOOR SYSTEM 33**. Megjithate, eshte e keshillueshme, qe perdoruesit te perdorin doreza dhe syze mbrojtese gjate perzierjes dhe aplikimit te produkteve.

TE DHENAT TEKNIKE (pas 7 ditesh, ne temperature +23°C)

Ngjitja (DIN ISO 4624)	> 1.5 N/mm ²
Rezistenca ndaj abrazionit (TABER CS 17)	90 mg
Koeficienti i bymimit termik (DIN 53752)	4x10 ⁻⁶ °K
Rezistenca ne shtypje (DIN EN 196)	70 N/mm ²
Rezistenca ne perkulje (DIN EN 196)	30 N/mm ²
Moduli i elasticitetit (DIN 1048)	18000 N/mm ²
Rezistenca ndaj temperatures se ajrit	-20°C - +60°C
Aspekti i jashtem	i shkelqyeshem